

Galeria e Arteve në Tiranë

NË GALERINË KOMBËTARE TË ARTEVE

Një pikto greke për Shqipërinë dhe shqiptarët

Çelet ekspozita dhe përurohet Albumi për Shqipërinë i piktores greke Aliko Tombrou, botim i Shtëpisë Botuese "Toena". Ditën e shtunë, më 3 qershor 2006, ora 18.30, në mjediset e Galerisë Kombëtare të Arteve do të çelet ekspozita "Shqipëria - Eksplorim nr.4", e piktores greke Aliko Tombrou. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më datën 10 qershor 2006. Në ceremoninë e çeljes do të jetë e pranishme edhe piktorja Aliko Tombrou, edhe pse në moshë të thyer mbi 80-vjeçare. Me këtë rast do të përurohet edhe albumi i pik-

JETËSHKRIMI
Aliko Tombrou ka lindur në Athinë. Është diplomuar në Artet e Bukura të Universitetit të Athinës. Ka studiuar në Academie de la Grande Chaumière dhe në Ecole des Beaux Arts në Paris. Është e martuar dhe ka dy fëmijë. Që prej 1960-s është prezent me ekspozita personale, si dhe me pjesëmarrje në ekspozita kolektive. Gjatë udhëtimeve të saj, në njëzet e pesë shtete të ndryshme, ka vizituar gjithë muzeumet më të mëdhenj të këtyre vendeve.

turave të kësaj piktoje, si dhe shënimet mbi përshtypjet e saj gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri në kohën kur ka realizuar pikturat. Albumi, i titulluar "Shqipëria - Eksplorim nr.4", është botim i Shtëpisë Botuese "Toena" dhe është i reali-

zuar në dy gjuhë dhe në dy botime: një botim anglisht-shqip dhe botimi tjetër greqisht-shqip. Kjo veprimtari organizohet nga Shoqata "Miq të Kolegjit Arsakeio" Tiranë, Galeria e Arteve Tiranë dhe Shtëpia Botuese "Toena".

BOTIME

Libra nga Aliko Tombrou, ku ndërthuren piktura me prozën - "Greqia" Eksplorim Nr. 1 - "Jerusalem" Eksplorim Nr. 2 - "Hapa në hije" Eksplorim Nr. 3 Nderuar me çmim nga Akademia e Athinës - "Shqipëria" Eksplorim Nr. 4 - "Konstandinopoja" Eksplorim Nr. 5 - "Thraka" Eksplorim Nr. 6

Përkthehen vargjet e amerikanit, që donte të vizitonte Shqipërinë

Frederick Turner, poeti që riktheu format e vjetra

Ndonëse të zgjedhura nga më shumë se dy mijë poezi, poezitë e përfshira "Në Shpellën e Platonit" nuk janë patjetër poezitë më të arrira të poetit anglo-amerikan, por më tepër shembuj nga shumëllojshmëria stilistike e poetit Frederick Turner.


Është cilësuar si një eveniment i rëndësishëm në historinë e marrëdhënieve kulturore midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë ajo që do të ndodhi në 3 qershor 2006. Këto ditë shtëpia botuese internacionale, "Marinaj Publishing", ka botuar një përmbledhje me poezi të zgjedhura nga krijimtaria e poetit të famshëm amerikan Frederick Turner. Libri është i përkthyer në shqip nga Gjeke Marinaj dhe do të prezantohet për herë të parë publikisht më datën 3 qershor në Sallën e Kinemasë, në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës.

Ftesa

Në këtë aktivitet janë ftuar të marrin pjesë një numër i konsiderueshëm shkrimtarësh, politikanësh aktivë shqiptarë, ambasadorja amerikane në Shqipëri, si dhe media shqiptare. Në ceremoni do të lexohet përshëndetja e poetit Frederick Turner, i cili ishte ftuar nga Drejtori i QNK-së, Mujo Buçpapaj, për të marrë pjesë në këtë eveniment, por pas një operacioni të paparashikuar mjekësor që pati në Teksas, Turner-it iu desh ta anulonte vizitën e tij në Shqipëri.

Cilësimet

Frederick (Frederik) Turner është i njohur si një nga poetët më cilësorë në letërsinë e sotme botërore. Nuk mund të jetë ndryshe, sepse vargjet e tij janë thellësisht të fuqizuara, midis tjerash, nga intelekti i një profesori të shquar në fushën e letërsisë, nga emocionet e një



Frederick Turner

FREDERICK TURNER

Frederick Turner është i njohur si një nga poetët më të rëndësishëm të letërsisë së sotme botërore, kandidat për Çmimin "Nobel" në letërsi (këtë vit i propozuar nga 41 universitete dhe organizata të akredituara letrare nga e gjithë bota, fitues i çmimit "Pen International", Çmimit "The Milan Fust Prize" (çmimi më i lartë letrar i Hungarisë), Çmimit "Gjenima," Çmimit "Levinson Prize" etj, etj. Kryeredaktor i revistës letrare famëmadhe "Kenyon Review", drejtues i institutit letrar të Teksasit, profesori themelues i shkollës së Arteve dhe Humanitetit pranë Universitetit të Teksasit në Dallas, ka bërë pjesë në disa dokumentare televizive, përfshi këtu dhënien e çmimeve të "The Emmy and Golden Eagle", dhe është në bordin e këshilltarëve të disa institucioneve kulturore dhe letrare.

Rikthimi

Kur Turner filloi të botojë për herë të parë, bota e poezisë ishte gjerësisht e dominuar nga tradicionalizmi poetik: vargje e lira imagjinatave dhe ekzistencialiste të shkruara zakonisht në vetën e

SHQIPËRUESI

Gjekë Marinaj është presidenti i Shoqatës së shkrimtarëve shqiptaro-amerikanë, poet dhe publicist i mirënjohur shqiptaro-amerikan, dhe autori i poemës "Kuajt", e cila ndihmoi Shqipërinë në revoltat e saj kundër ish qeverisë së saj despotike. I lindur në Shqipëri, mezi u shkëput i gjallë nga Shqipëria më 12 shtator të vitit 1990 dhe është tani nënshtrës amerikan, por me lidhje të përhershme me vendin e tij të lindjes.

parë. Turner, ndoshta më shumë se çdo poet tjetër, mban përgjegjësinë e rikthimit të formave të vjetra, si dhe për krijimin e disa prej formave të reja poetike, që sot gjejmë të aplikuar në poezinë bashkëkohore.

STUDIMI



Viktor Canosinaj prezanton "Nga Liza te Harri Poteri"

Është cilësuar pa frikë si një vepër shumë e rëndësishme studimore mbi letërsinë për fëmijë. Duket se kritika dhe studimet letrare në fushën e letërsisë sonë për fëmijë e të rinj, megjithë përpjekjet e përkushtuara të një sërë kritikësh e studiuesish, janë ende të mangëta dhe jo në nivelin e kritikës dhe studimeve të letërsisë për të rritur. Në këtë kuadër, letërsia botërore bashkëkohore për fëmijë e të rinj, është edhe me e pastudiuar, e njohur fare pak jo vetëm nga mësuesit, pedagogët, studentët, lexuesit, por edhe nga vetë krijuesit e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj. Gjykuar në këtë plan, libri studimor i shkrimtarit Viktor Canosinaj, «Nga Liza te Harri Poteri», i vetmi botim i derisotëm për letërsinë bashkëkohore për fëmijë e të rinj, i cili doli në qarkullim këto ditë dhe u promovua dje në festën e fëmijëve. Autori, që shquhet më tepër si krijues, në këtë libër e rrëfen veten se ka prirje edhe në fushën e kritikës dhe të studimeve letrare. Vepra është shkruar me një stil e gjuhë të qartë e të rrjedhshme, me frymëzim e përkush-

TRAJTIMI

Në studim trajtohet koncepti mbi fëmijërinë dhe si ka evoluar ai nëpër shekuj, deri në ditët tona. Ai është ndërtuar në disa kapituj, ku fillimisht trajtohen problemet teorike të letërsisë për fëmijë dhe veçoritë e saj, formatimin artistik që në shumë raste e dallon atë nga letërsia për të rritur. Ndërsa korpusin kryesor të veprës e zë vështrimi historik, që daton me veprat e para didaktiko-fetare të shkruara për fëmijë në shekujt XVI-XVII. Ky libër mund të shfrytëzohet si një literaturë e dobishme nga mësuesit e shkollave, pedagogët e fakulteteve, nga studentët, nga fëmijët e të rinjtë e apasionuar pas kësaj lloji letërsie.

tim dhe autori pas një pune të gjatë, pse jo dhe të mundimshme në shfletimin e mijëra faqeve literaturë, është përpjekur të sjellë sa më tepër njohuri dhe informacion për lexuesin e interesuar.